



Sqarime të mëtejshme në lidhje me rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore!

Nëpërmjet një njoftimi për shtyp të datës 24.04.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka sqaruar vendimmarrjen e tij të datës 22.04.2020 për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore më datë 27.04.2020.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka theksuar se Vendimi nr. 143, datë 22.04.2020 *“Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”* (“Vendimi nr. 143”) do të zbatohet në përputhje me dhe sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 25.03.2020 *“Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”*, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 16.04.2020.

Në këtë kuptim, Këshilli i Lartë Gjyqësor sqaron më tej se:

- Veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore do të kufizohen vetëm në ato çështje me natyrë të ngutshme, ndërsa ato me natyrë jo të ngutshme do të vijojnë të jenë të pezulluara;*
- Afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale të një natyre jo të ngutshme vazhdojnë të pezulluara.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk sqaron në këtë njoftim për shtyp kuptimin e kategorisë së “çështjeve me natyrë të ngutshme” apo “çështje me natyrë jo të ngutshme”.

Sjellim në vëmendje se, në Vendimet e mëparshme të pezullimit, konkretisht Vendimi nr. 127, datë 10.03.2020, Vendimi nr. 128, datë 24.03.2020 dhe Vendimi nr. 133, datë 06.04.2020, Këshilli i Lartë gjyqësor përjashtonte nga efektet e pezullimit veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme. Kësisoj mbetet për t’u sqaruar në vijim gama e çështjeve që rifillojnë sipas Vendimit nr. 143.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor njofton se është ngritur një komision i posaçëm për hartimin e një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor do të njoftojë në ditët në vijim zhvillimet e reja dhe sqarimet përkatëse.



Additional clarifications related to the recommencement of the judicial activity!

By the means of a Press Release dated 24.02.2020, the Supreme Judicial Council has elaborated on its decision of 22.04.2020 regarding the resumption of judicial activity and services starting from 27.04.2020.

The Supreme Judicial Council has emphasized that Decision no. 143, date 22.04.2020 *“On the resumption of judicial activity and services”*, will be implemented in strict accordance and compliance with Normative Act of the Council of Ministers no. 9 *“On provisional measures regarding judicial activity, during the duration of the epidemic caused by COVID-19”*, approved by the Parliament of the Republic of Albania on 16.04.2020.

In this context, the Supreme Judicial Council explains that:

- *The judicial activity and services will be limited only to cases of pressing nature, while other cases not of this nature will continue to be suspended;*
- *Statute of limitations (i.e. time limits within which an action must be brought to court) with respect to lawsuits, appeals and any other procedural action in administrative, civil and criminal court cases which are not of a pressing nature, will remain suspended.*

The Supreme Judicial Council does not provide any explanation with regard to the meaning of the categories of “cases of a pressing nature” and “cases not of a pressing nature”.

We bring to your attention that in the previous decisions on suspension, specifically Decision no. 127, dated 10.03.2020, Decision no. 128, dated 24.03.2020, Decision no. 133, dated 06.04.2020, the Supreme Judicial Council expressly excluded from the effects of the suspension the cases of a pressing nature. Therefore, further clarifications are needed with regard to the cases which effectively will resume their activity by the means of Decision no. 143.

Furthermore, the Supreme Judicial Council notifies that a commission is established with the aim of preparing a plan of measures regarding judicial activity.

The Supreme Judicial Council will notify the new developments and the respective explanations in the upcoming days.